



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA KOMUNA-
MALISHEVË/ QKMF “DR. SHPËTIM ROBAJ” NË MALISHEVË

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Në bazë të nenit 77 paragrafi 1 dhe 2, nenit 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr. 08/L-197. Rregullores (QRK) -Nr.30/2024 Për Procedurën e Pranimiit Të Nëpunësve Të Shërbimit Publik Në Sektorin e Shëndetësisë. Në bazë Ligjit Për Pagat në Sektorin Publik Nr. 08/L-196 shtojcës 9 numër 13 si dhe në bazë të njoftimit të Masës Monetare të nr: 04/32 të datës: 16.01.2025 të Zyrës për Buxhet dhe Financa në Komunën e Malishevës QKMF- “Dr. Shpëtim Robaj” në Malishevë shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS.

Titulli i vendit të punës: INFERMIER/E në QKMF- Dr. “Shpëtim Robaj” Malishevë.

Institucioni:	Komuna e Malishevës
Departamenti/ Drejtoria:	Drejtoria Për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- QKMF
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave	7 Shtatë.
Titulli i mbikëqyrësit	Drejtori i QKMF-së
Grada/ Koeficienti	H-17-5.4/ H-20-5.1/ H-21-4.5
Kohëzgjatja e emërimit	Me kohë të pa caktuar
Periodha provuese	6 (gjashtë) muaj

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e zyrtarëve publikë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale.
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë.

- Pranon dhe triazhon pacientët në QKMF
- Përgatitë pacientët për vizitë mjekësore
- Kryen punë administrative shëndetësore
- Përgjigjet për participimin e pacientëve
- Kryen sipas nevojës punët e kartotekës, intervencës, patronazhit, terrenit dhe edukimit
- Bënë aplikimin e terapisë si dhe përcjelljen e shenjave vitale gjatë kohës së transportit të pacientëve,
- Bënë bartjen e pacientëve prej shërbimit deri në ambulant dhe anasjelltas

- Sipas urdhrit të shefit të mjekësisë familjare kryen edhe punë tjera
- Për punën e vet i përgjigjet Kryeinfermierit/es dhe Shefit të Sektorit të Mjekësisë Familjare.

Dokumentet e nevojshme:

- Diplomën e Fakultetit të Infermierisë - Bachelor ose diplomën e Shkollës së Mesme të Mjekësisë, (kopjen e noterizuar)
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, diploma duhet njihet nga MASHT:
- Licencën e punës me afat (kopjen e noterizuar).
- Formulari i aplikimit i plotësuar (origjinalin)
- Rezumeja personale (CV)
- Certifikatën e lindjes: (origjinalin).
- Certifikatën që nuk është nënë hetime ose i dënuar në Gjykatë (origjinalin).
- Letërnjoftimin të fotokopjuar .
- Certifikatën e mjekut për punë (pas përzgjedhjes nga Komisioni)
- Përvoja e punës (e dëshirueshme)

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe të noterizuara, siç janë të renditura më lart.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

- Testimi me shkrim deri në 70 pikë
- Intervistimi deri në 30 pikë

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike, aplikacionet dorëzohen nga data 16.01.2025 deri me dt: 14.02.2025. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Administratën e QKMF-së ditëve të punës, e hënë e premte prej: 08-00 deri ora 14/00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në linkun e më poshtëm

- Konkursi shpallet në linkun: <http://konkursi.rks-gov.net> si dhe në tabelën e shpalljeve në K.K-Malishevë dhe në QKMF. Të gjitha njoftimet e tjera dhe shpalljet vendosen në tabelën e shpalljeve në QKMF- Malishevë si dhe në Web faqen e komunës së Malishevës
- Informacione të sakta do të konsiderohen vetëm ato informata të cilat dëshmojnë me dokumente.
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Malishevë datë:
16.01.2025

DREJTORI I QKMF-së
Dr. Afrim Krasniqi, Spc. Mjek Familjar

